

PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT (PLL)

HISTORIKU

Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL) është një parti kombëtare me qendër në Tiranë, e cila mbështet restaurimin e monarkisë në Shqipëri, regjistruar zyrtarisht në vitin 1992. Në statutin e PLL, në nenin 1 të saj shkruhet që 'partia "Lëvizja e Legalitetit" ka lindur si lëvizje për mbrojtjen e legjitimitetit dhe rendit kushtetues. Origjina e Lëvizjes Legaliste lidhet ngushtë me ngjarjet politike të viteve 1920-1939 dhe me veprimtarinë e aktet e figurës politike të Ahmet Zogut, i cili në vitin 1928 e shpalli veten e tij si 'Mbret të Shqipërisë dhe shqiptarëve'. Në lidhje me emrin Legalitet, peshën kryesore në këtë kontekst e mban data 24 dhjetor 1924, kur forcat qeveritare, të kryesuara nga Ahmet Zogu, arrijnë të rikthejnë në pushtet, qeverinë e ligjshme të kryeministrit Iljaz Vrioni. Kjo ngjarje historike është njohur dhe quajtur si Triumf i Legalitetit. Qeveria Vrioni ishte rrëzuar me forcën e armëve pas një rebelimi ushtarak, të organizuar nga opozita e asaj kohe, që udhëhiqej nga kryetari i Partisë Popullore Fan Noli. Qartësisht, PLL është e vendosur në spektrin e djathtë të politikës shqiptare. Pas vitit 1945, legalistët e zhvilluan aktivitetin e tyre në mërgim derisa në Shqipëri u vendos sërish sistemi demokratik në fillim të viteve 1990-të. Por ndryshe nga partitë e tjera politike që u regjistruan menjëherë pas rënies së komunizmit, gjatë fillimit të vitit 1991, PLL e kishte më të vështirë që të regjistrohej zyrtarisht për shkak të klauzolave ligjore që e pengonin këtë gjë. Kështu që pas disa kërkesash ligjore dhe përpjekjesh, PLL u regjistrua më 20 shkurt 1992. Ndërkohë drejtuesit e saj në diasporë kishin ardhur disa herë në Shqipëri dhe u angazhuan në organizimin e Kongresit të XII-të, që u quajt kongresi i bashkimit të Legalitetit. Ky kongres ishte i dyti që mbahej në atdhe, pas atij të Zall-Herit më 1943. Në mërgim ishin zhvilluar 10 kongrese, që prej vitit 1962. Nga Kongresi i 12-të i Legalitetit, 29-30 maj 1993 në Pallatin e Kongreseve në Tiranë u zgjodh kryetar Guri Durollari, i cili në zgjedhjet e vitit 1996 mori rezultate modeste. Në zgjedhjet e 29 qershorit 1997, PLL mori për herë të parë dy mandate deputetësh në Kuvend të cilat ishin Guri Durollari dhe Spartak Ngjela, si dhe u bë dhe një referendum popullor për formën e qeverisjes së vendit. Më 12 korrik Mbreti Leka I dhe një pjesë e stafit të tij largohet nga Shqipëria, pas një qëndrimi 3-mujor në Shqipëri (12 prill-12 korrik). Pas ngjarjeve të '96-'97-ës, në PLL kishte zhvillime e debate të vazhdueshme, të cilat kulmuan me thirrjen e një Kongresi të Jashtëzakonshëm, i cili u mbajt më 12 prill 1998 dhe në të cilin u zgjodh kryetar Ekrem Spahia. Pas vrasjes së deputeti Azem Hajdari në shtator të vitit 1998, kryetari i PLL Ekrem Spahia akuzohet për kryengritjen e armatosur të 14 shtatorit 1998 dhe mbahet në burg për 13 muaj. Në zgjedhjet parlamentare të 24 qershorit 2001, PLL arrin që të fitojë 5 mandate deputetësh ndërmjet të cilëve dhe të kryetarit Ekrem Spahia. Në zgjedhjet e vitit 2005 dhe vitit 2009, PLL nuk arriti që të përfaqësohej në Kuvendin e Shqipërisë por në qeverinë Berisha II, të dalë pas zgjedhjeve të vitit 2009, Ekrem Spahiu u emërua si zëvendësministër i Turizmit,

Kulturës, Rinisë e Sporteve. PLL nuk arriti ndonjë rezultat pozitiv gjatë zgjedhjeve të vitit 2013, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2017 nuk mori pjesë duke e argumentuar si 'për mënyrën sesi u organizuan këto zgjedhje'. Në nëntor të vitit 2017 u mbajt Kongresi XIX i PLL dhe kryetar u zgjodh Shpëtim Axhami (Akhani).

KRYETARI - SHPËTIM AXHAMI

BIOGRAFIA

Në internet qarkullojnë dy mbiemra Axhami dhe Axhani. Në KQZ duhet që të jetë regjistruar me mbiemrin Shpëtim Axhani. Qarkullojnë shumë shkrime për PLL por nuk ka ndonjë jetëshkrim të publikuar të tij ose aktiviteti me të cilin është marrë përpara se të bëhej kryetar i PLL.